



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2 pika d të Ligjit nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare nr.28/15 qershor 2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2023 mori këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL OBILIQ PËR VITIN 2024

I

APROVOHET Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024

II

Kuvendi i Komunës së Obiliqit planifikon të mbajë 12 mbledhje të rregullta dhe secilës mbledhje i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa

III

Aktet Komunale dhe propozimet të cilat planifikohen të shqyrtohen në mbledhjet e Kuvendit të Komunës në vitin 2024 janë si në vijim:

Janar Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	1. Raporti Vjetor I Punës së Kuvendit Komunal. 2. Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Shkurt Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	1. Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023. 2. Plani I Punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2024. 3. Raporti vjetor i punës nga NPL- "Kastriotit" SH.A Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	17.02.2024 Mbledhje Solemne në nder të Shpalljes së Pavarsisë së shtetit të Kosovës.
Mars Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit 05.03.2024 Mbledhje Solemne	1. Bartja e mjeteve nga THV nga viti 2023 në vitin 2024. 2. Plani vjetor I Punës për auditim të mbrendshëm Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	05.03.2024 Mbledhje Solemne Me rastin e shënimit të 26 vjetorit të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe Epopesë së UÇK-së.
Prill Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	1. Shqyrtimi i Raportit financiar: Janar – Mars 2024 Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Maj Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	Vizitë zyrtare e KK
Qershor Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	1. Shqyrtimi dhe Aprovimi I Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB-it) 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026 2. Rishikim i Buxhetit për vitin 2024 3. Rishikimi I plantit të zyrës së prokurimit	14.06.2024, Mbledhje Solemne për nder të 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit

	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Korrik Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	1. Shqyrtimi i raportit financiar Janar – Qershor 2024 2. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 3. Plani I veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA. 4. Raporti gjashtëmujor I punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2024. 5. Raport i DKA-së për përfundimin e vitit mësimorë	
Gusht Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	1. Shqyrtimi I Raportit mbi pronat komunale. 2. Raport I DBZHR , mbi korrije –fshirje Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Shtator Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit komunal për vitin 2025 si dhe parashikimi për vitet 2026 dhe 2027. 2. Shqyrtimi i Vendimit për caktimin e normave për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025. 3. Raport mbi fillimin e vitit të ri shkollor Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	Vizitë zyrtare e KK
Tetor Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	1. Raport nëntë mujor financiar I shpenzimeve per vitin 2024. 2. Raporti i performancës për vitin 2023. Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Nëntor Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	1. Raport nga DSHMS-ja për ofrim të shërbimeve 2. Raport nga DIL- mbi projektet 3. Themelimi i komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit	

	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	
Dhjetor Mbledhja e KPF-së Mbledhja e Kuvendit	1. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024. Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave	

Me rekomandim të Grupit punues, mbledhjet e Kuvendit Komunal të mbahen çdo herë në javën e tretë të çdo muaji

IV

4.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetencat e veta për përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dispozita tjera ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës Obiliq mban së paku dhjetë mbledhje të rregullta gjatë vitit kalendarik .

4.2 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta mbrenda vitit kalendarik .

4.3 Kuvendi i Komunës mund të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne.

V

Plani i mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si të pika III, të këtij Vendimi mundë të ketë ndryshime dhe plotësime tjera në rend dite gjatë vitit, varësisht nga nevojat dhe funksionalitetit në të mirë të Kuvendit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- Drejt.së ad.së përgj.
- MAPL
- Anëtarëve të KK

